

Dr. Musli Vërbani

Tregime nga mrekullitë e Muhamedit a.s.

(365 tregime për fëmijën tuaj brenda 12 muajve të vitit)

Kaçanik, 2020

Titulli:

Tregime nga mrekullitë e Muhamedit a.s.


Autor:

Dr. Musli Vërbani

Korrektues:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori



Tregime nga mrekillitë e Muhamedit a.s.



Pastrimi i zemrës së Muhamedit a.s.

Muhamedi a.s. i kishte katër vite.
Luante me fëmijët në shkretëtirë.
Me Muhamedin a.s. ishte edhe e motra e tij nga gjiri Shejma.
Shejma e sheh se Muhamedit a.s. po i ndodhë diçka e çuditshme.
E marrin dy njerëz me rroba të bardha.
E shtrijnë për toke Muhamedin a.s.
Ia hapin kraharonin dhe e operojnë.
Muhamedit a.s. ia nxjerrin një pikë të zezë nga zemra.
Ia pastrojnë zemrën me ujë të xhenetit.
Ia mbushën zemrën me urtësi.
Pastaj dy melekët ia kthejnë zemrën në vendin e vet.
Ia mbyllin kraharonin dhe ia qepin atë.
Pasi ia pastrojnë, e kthejnë Muhamedin a.s. ashtu si kishte qenë me parë.
Melekët ia mbyllin zemrën dhe ia vulosin **vulën e pejgamberisë**.

Muhamedi a.s. ishte në Mekke në shtëpinë e Umi Hanit.
Po flinte në dhomë.
I shkon Xhibrili a.s.
E preku Muhamedin a.s. në këmbë.
Muhamedi a.s. zgjohet nga gjumi, por nuk sheh gjë andaj vazhdon të flejë.
E preku përsëri dhe zgjohet.
E kap për krahu dhe dolën tek dera e xhamisë së Qabes.
Aty sheh një kafshë të bardhë me dy krahë.
Emri i tij ishte Burak.
Buraku është kafshë e cila ecte me shpejtësi të dritës.
Pak para se të fillonin udhëtimin,
Xhibrili ia hapi gjoksin dhe ia pastroi zemrën.
Ia fërkoj sytë Muhamedit a.s. me ujin e zemzemit.
E hipi Muhamedin a.s. mbi Burakun dhe u nisën së bashku.
Shpejtësia e Burakut ishte asisoj që, aq sa i shihnin sytë e tij në horizont, aq e hidhte hapin.
Kështu e bartën Muhamedin a.s. prej Mekës në Mesxhidi Aksa në Palestinë.
Ky udhëtim prej Qabes deri në Mesxhidi Aksa të Jerusalemit quhet **“Isra”**.
Aty Muhamedi a.s. bëhet imam i të gjithë peygamberëve dhe i falë dy rekate namaz.
Me këtë vërtetohet se Muhamedi a.s. **është vula e peygamberëve**.

Allahu xh.sh. thotë:

“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidul Haramit gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar (ia bëmë këtë udhëtim) për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi dhe pamës.”

Muhamedi a.s. ishte në Mekke në shtëpinë e Umi Hanit.
Po flinte në dhomë.
I shkon Xhibrili a.s.
E preku Muhamedin a.s. në këmbë.
Muhamedi a.s. zgjohet nga gjumi, por nuk sheh gjë andaj vazhdon të flejë.
E preku përsëri dhe zgjohet.
E kap për krah dhe dolën tek dera e xhamisë së Qabes.
Aty sheh një kafshë të bardhë me dy krahë.
Emri i tij ishte Burak.
Buraku është kafshë e cila ecte me shpejtësi të dritës.
Pak para se të fillonin udhëtimin,
Xhibrili ia hapi gjoksin dhe ia pastroi zemrën.
Ia fërkoj sytë Muhamedit a.s. me ujin e zemzemit.
E hipi Muhamedin a.s. mbi Burakun dhe u nisën së bashku.
Shpejtësia e Burakut ishte asisoj që, aq sa i shihnin sytë e tij në horizont, aq e hidhte hapin.
Kështu e bartën Muhamedin a.s. prej Mekës në Mesxhidi Aksa në Palestinë.
Ky udhëtim prej Qabes deri në Mesxhidi Aksa të Jerusalemit quhet **“Isra”**.
Aty Muhamedi a.s. bëhet imam i të gjithë peygamberëve dhe i falë dy rekate namaz.
Pasi i falë Muhamedi a.s. dy rekate namaz ngrihet në qiell.
Udhëtimi prej Mesxhidi Aksasë në tokë për në hapësira qiellore quhet **“Miraxh”**.

Muhamedi a.s. e kishte bërë Isranë.

Pas Israsë, Muhamedi a.s. bashkë me Xhibrilin u ngjitën lart në qiellin e dunjasë.

Qielli i dunjasë është qielli më i afërt.

Arritën në qiellin e parë.

Xhibrili a.s. i thotë rojës së qiellit:

- Hape portën!

Roja e pyet: - A është tjetër kush me ty?!

- Po! Me mua është Muhamedi.

- A është i ftuar?!

Xhibrili i tha: - Po.

Kështu ai e hap portën.

Në qiellin e dunjasë, rrugës panë të ulur një burrë.

Në të djathtë të tij një mori njerëzish.

Në të majtë një mori tjetër njerëzish.

Kur shikonte nga e djathta, qeshte.

Kur shikonte nga e majta, qante.

Ai i tha: - Mirë se vjen, Pejgamber i drejtë!

Mirë se vjen bir i drejtë!

E pyet Xhibrilin: - Kush është ky?

Xhibrili i thotë: - Ky është Ademi (babai i njerëzimit),

ndërsa turmat e mëdha në të djathtë dhe në të majtë të tij janë pasardhësit e tij.

Kur shikon nga e djathta ai qesh.

Kur shikon nga e majta ai qan.

Ata nga e djathta janë banorët e Xhenetit.

Ata nga e majta janë banorët e Zjarrit.

Gjatë Miraxhit, prej qiellit të dytë deri në qiellin e gjashtë

Muhamedi a.s. e kishte vazhduar udhëtimin e Miraxhit.
Pas qiellit të parë, Muhamedi a.s. ngjitet në qiellin e dytë.

Xhibrili i thotë rojës: - Hape portën!
Roja e pyet: - A është tjetër kush me ty?!
- Po! Me mua është Muhamedi.
- A është i ftuar?!
Xhibrili i thotë: - Po.

Në qiellin e dytë Pejgamberi takoi Isain a.s. dhe Jahjain a.s.
Ata e përgëzuan, i folën me fjalë të këndshme dhe të mira.

Pastaj ngrihet në qiellin e tretë.
Në qiellin e tretë e takon Jusufin a.s.

Ngrihet në qiellin e katërt.
Në qiellin e katërt takon Pejgamberin Idris a.s.
Kur kaluan pranë Idrisit ky i tha: - Mirë se vjen o Pejgamber i drejtë dhe vëlla i drejtë.

Ngrihet në qiellin e pestë.
Në qiellin e pestë e takon Harunin a.s.
Kur kaluan pranë Harunit a.s. ky i tha: - Mirë se vjen o Pejgamber i drejtë dhe vëlla i drejtë.

Ngrihet në qiellin e gjashtë.
E pyet Xhibrilin: - Kush është ky?!
Xhibrili i thotë se ky është Musai!
Musai i tha:
Mirë se erdhe o Pejgamber i drejtë.
Mirë se erdhe o vëlla i drejtë.

Takimi i Muhamedit a.s. me Ibrahimin a.s.

Në natën e Miraxhit Muhamedi a.s. ngrihet në qiellin e shtatë.

Në qiellin e shtatë e takon Ibrahimin a.s.

Ibrahimi rrinte mbështetur në **Bejtul Mamur**.

Në **Bejtul Mamur** çdo ditë hynin nga 70 mijë melekë dhe nuk dilnin më.

Xhibrili i thotë: - Ky është babai yt, Ibrahim. Jëpi selam atij!

Muhamedi a.s. e përshëndetë me selam.

Ibrahimi a.s. ia ktheu selamin.

Ibrahimi a.s. i thotë:

- Mirë se erdhe biri im i mirë!

Mirë se erdhe Pejgamber i mirë!

Pastaj Ibrahim a.s. i thotë:

- O Muhamed! Jëpi selam umetit tënd nga unë.

Njoftoje se xheneti është shumë i bukur.

Uji është shumë i ëmbël.

Sipërfaqja është mjaft e gjerë dhe e sheshtë.

Gjithashtu u thuaj që të mbjellin shumë pemë.

Pemët e xhenetit mbillen duke i përmendur fjalët:

“Subhanallahi ve'l-hamdu lil-lahi

Ve la ilahe il-lAllahu

VAllahu ekber!”

Përrshëndetja prej banorëve të qiellit për Muhamedin a.s.

Xhibrili zbret në tokë.
Shkon te Muhamedi a.s.
Ia hap gjoksin.
Ia pastron zemrën e tij me ujë të zemzemit.
Fillimisht e kishte bërë udhëtimin për në mesxhidi **Aksa**.

Pas Israsë është ngritur në qiellin e kësaj bote.
Troket në njërën nga dyerve të saj.
Atëherë banorët e qiellit e pyesin.
- Kush është?
Xhibrili u përgjigjet: - Unë.

Pastaj e pyesin: - Kush është me ty?
Xhibrili u përgjigjet: - Muhamedi.

Ata i thonë: - Ai i cili është peygamber?
Xhibrili u thotë: - Po.

Atëherë u thonë: - Mirë se keni ardhur!
Banorët e qiellit gëzohen për takimin me Muhamedin a.s.
Ata e përgëzojnë njëri-tjetrin për takimin me Muhamedin a.s.

Bejtul Maëmurë

Muhamedi a.s. gjatë Miraxhit ka parë mrekulli të shumta.

Një nga mrekullitë është arritja në **Bejtul Maëmurë**.

Bejtul Maëmurë do të thotë “**Shtëpia e luleve**”.

Në **Bejtul Mamur** çdo ditë hynin nga 70 mijë melekë dhe nuk dilnin më.

Në Bejtul Mamurë ia paraqesin tre gota për të zgjedhur:

- Një gotë me alkool.
- Një gotë me qumësht.
- Një gotë me mjaltë.

Muhamedi a.s. e zgjodhi gotën me qumësht.

Në këtë rast Xhibrili a.s. i thotë:

- **Të drejtën e ke zgjedhur.**

Kjo është “natyrshmëria”,

ajo ku gjendesh ti dhe populli yt.

Sidretul Munteha

Muhamedi a.s. gjatë Miraxhit ka parë mrekulli të shumta.
Një nga mrekullitë është arritja në pikën kulminante.
Pika kulminante është **“Sidretul Munteha”**.
Në Sidretuul Munteha kishte pemë të mëdha.
Gjethet e luleve ishin të mëdha.
Sidretul Munteha ishte shumë e bukur.
Askush nuk mund ta përshkruajë bukurinë e saj.
Aty shikon fruta të mëdha.
Pemët gjithashtu kishin gjethë të mëdha.

Xhibrili i thotë:

- Kjo është Sidretul Munteha!

Aty Muhamedi a.s. sheh katër lumenj.
Dy lumenj ishin brenda.
Dy lumenj ishin jashtë.

E pyeti Xhibrilin për këto dy lumenj.

Xhibrili i thotë:

- Dy lumenjtë që janë brenda janë lumenjtë e Xhennetit.

Dy lumenjtë jashtë janë:

- Lumi Nil dhe
- lumi Eufrat.

Obligueshmëria në Sidretul Munteha

Sidretul Munteha është në kulminacionin e gjithësisë.
Në Sidretul Munteha përfundojnë gjithësitë dhe krijesat.

Allahu i shpalli dhe obligoi me 50 namaze gjatë ditës e natës.
Gjatë kthimit për në tokë Muhamedi a.s. e takon Musain a.s.
Musai a.s. i thotë:
- Kthehu tek Allahu,
lute që ta lehtësoje sepse populli yt nuk do e përballojë.

Kthehet tek Allahu dhe i thotë:
- O Zoti im! Lehtësoje popullin tim!
Allahu ia uli në 25 kohë namazin.
Gjatë kthimit për në tokë prapë e takon Musain a.s.

Musai a.s. i thotë:
- Kthehu tek Allahu,
lute që ta lehtësoje sepse populli yt nuk do e përballojë.

Kthehet tek Allahu dhe i thotë:
- O Zoti im! Lehtësoje popullin tim!
Allahu ia uli në pesë kohë namazi.

Në kthim takon përsëri Musain a.s.
I thotë që Allahu xh.sh. i uli në pesë kohë namazi.
Musai a.s. i tha:
- Kthehu tek Allahu, lute që ta lehtësojë sepse populli yt nuk do e përballojë.
Muhamedi a.s. i thotë Musait a.s.:
- Jo, turpërohem të kërkoj përsëri.

Allahu xh.sh. i thotë Muhamedit a.s.:
O Muhamed! Ato janë pesë namaze që falen gjatë ditës dhe natës.
Çdo namaz shkruhet për dhjetë, kështu që plotësohen 50 namazet.

Muhamedi a.s. përgjatë miraxhit e takon Ademin a.s.

Pastaj kalon prej qiellit të kësaj bote.

E sheh një lumë.

Mbi atë lumë një kështjellë prej diamanti.

E prek me dorën e tij.

Kur i morën erë i vinte era miskë.

E pyet Xhibrilin:

- Çka është kjo o Xhibril?

Xhibrili i thotë:

- Ky është Kevtheri.

Zoti yt Kevtherin e ka bërë për ty.

Uji i Kevtherit është më i bardhë se qumështi.

Shija e tij është më i ëmbël se mjalti.

Era e tij është më e mirë se era e miskut.

Në të janë gotat, pjatat të cilat e kanë shkëlqimin si shkëlqimi i yjeve.

Në të janë gotat, të cilat e kanë shkëlqimin si shkëlqimi i yjeve.

Kush pi ujë prej atij uji nuk ndien pastaj etje kurrë.

Lutja e përshëndetjes (Ettehiatu)

Muhamedi a.s. kishte shkuar në Sidretul Munteha.
 Sidretul Munteha është vendi në kulminacionin e gjithësisë.
 Aty përfundojnë gjithësitë dhe krijesat.
 Në Sidretul Munteha, Muhamedi a.s. i thotë Zotit të Lartmadhëruar:
 ETTEHIJU LILAH
 VES-SALAVATU
 VET-TAJJIBATU.
 “Çdo përshëndetje, çdo bekim dhe çdo mirësi është për Zotin.”

Zoti i Lartmadhëruar i thotë:
 ESSELAMU ALEJKUM EJJIHEN NEBIJU
 VE RAHMETULLAHI
 VE BEREKATUHU.
 “Paqja qoftë mbi ju o i dërguar.
 Mëshira e Zotit qoftë mbi ju o i dërguar.”

Muhamedi a.s. i përgjigjet:
 ESSELAMU ALEJNA
 VE ALA I BADIL-LAHI SALIHINË.:
 “Paqja qoftë mbi ne
 dhe mbi robërit e mirë dhe të devotshëm.”

Në atë moment Xhibrili besnik e deklaron dëshminë e shehadeit:
 ESHHEDU EN LA ILAHE IL-LA-LLAH
 VE ESHHEDU ENNE MUHAMEDEN ABDUHU VE RESULUHU.
 Dëshmoj dhe deklaroj se vetëm Allahu është Zot.
 Dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi është i dërguar i Zotit dhe rob i tij.

Muhamedi a.s. ndodhej në vendin e quajtur Themed.
Ishte një ambient shkretinor dhe i thatë.
Nuk kishte ujë.
Uji ishte harxhuar.

Shokët e Muhamedit a.s. kishin mbetur pa ujë.
Ishin shumë të etur.
Kishin nevojë për ujë.
Kishin nevojë për ujë për t'u pastruar.
Kishin nevojë edhe për abdes.
Shokët i treguan Muhamedit a.s. për mungesë të ujit.

Muhamedi a.s. nxori një shigjetë.
Ua jep shokëve duke u thënë që ta ngulnin në burimin Themed.
Pastaj kërkoi një enë uji.
Muhamedi a.s. u lut për ujë.
Uji i burimit filloi menjëherë të gurgullojë.

Burimi Themed vazhdoi gjersa të gjithë shokët pinë.
Burimi Themed vazhdoi të burojë gjersa të gjithë shokët morën abdes.

Merimanga në shpellën Thevr

Muhamedi a.s. ishte duke shkuar për në Medine.
 Udhëtimi për në Medine quhet Hixhret.
 Së bashku me Muhamedin a.s. ishte Ebu Bekri.
 Pejgamberi fshihet në një shpellë.
 Shpella quhej Thevr.

Një hyrje të shpellës Thevr shkon një merimangë.
 Merimanga kishte shkuar të thurë një pëlhurë të saj.
 Rrjeta e zuri në tërësi hyrjen e shpellës.

Idhujtarët i shkuan pas Muhamedit a.s dhe Ebu Bekrit,
 kërkonin gjithandej dhe në çdo vend.
 Prej së largu e shohin shpellën Thevr.
 I afrohen hyrjes së shpellës.
 E shohin se rrjeta e saj ishte e zënë e gjitha nga pëlhura e merimangës.

Idhujtarët deshën të futen brenda.
 Ebu Bekri r.a. i tha të dërguarit a.s.:
 - Sikur të shikonte ndonjëri poshtë këmbëve të tija do të na shihte.
 I dërguari a.s. iu përgjigj:
 - O Ebu Bekr, çfarë thua ti për **dy veta kur janë e Allahu është i treti?**

Ubej bin Halef u tha:
 - **Mos u futni brenda, po të kishte njeri brenda, rrjeta e merimangës do të ishte prishur.**

Pëllumbi në shpellën Thevr

Muhamedi a.s. ishte duke shkuar për në Medine.
 Udhëtimi për në Medine quhet Hixhret.
 Së bashku me Muhamedin a.s. ishte Ebu Bekri.
 Pejgamberi fshihet në një shpellë.
 Shpella quhej Thevr.

Një hyrje të shpellës Thevr shkojnë dy pëllumba.
 Dy pëllumba shkojnë të vendosin follenë e tyre.

Idhujtarët i shkuan pas Muhamedit a.s. dhe Ebu Bekrit.
 Kërkonin gjithandej dhe në çdo vend.
 Ndiqnin nga pas për t'i vrarë.
 Prej së largu e shohin shpellën Thevr.
 I afrohen hyrjes së shpellës.
 E shohin se pëllumbi kishte thurë strofullin.
 Në strofullin e saj kishte lëshuar vezët e saj.
 Idhujtarët deshën të futen brenda.
 Ebu Bekri r.a. i tha të dërguarit a.s.:
 - Sikur të shikonte ndonjëri poshtë këmbëve të tija do të na shihte.
 I dërguari a.s. iu përgjigj:
 - O Ebu Bekr, çfarë thua ti për dy veta kur janë e Allahu është i treti?

Ubej bin Halef u tha:
 - Mos u futni brenda,
 po të kishte njeri brenda në shpellë, pëllumbat do të kishin ikur.

Të folurit e qengjit

Muhamedi a.s. shkon në Hajber te një fis jehud.
Një grua prej Hajberi i solli të Dërguarit të Allahut një qengj të gatuar.
Ajo e kishte helmuar.

Shpatulla e qengjit tregoi se ishte e helmuar.
Pejgamberi a.s. tha: - Mos e hani.
Kjo shpatull më tha që mishi është i helmuar.

Pejgamberi a.s. mishin ia hodhi një qeni.
Qeni ngordhi pasi e hëngri.

Gruaja u soll para të Dërguarit të Allahut.
Pejgamberi e pyeti:
- Përse e helmove mishin?

Gruaja i tha:
Po të ishe Pejgamber helmi nuk do të helmonte.
Po të ishe mbret, njerëzit do të shpëtonin nga ti.

Pejgamberi a.s. e fali kur e dëgjoi arsyetimin e saj dhe nuk e ndëshkoi.
Edhe pse e meritonte dënimin, prapëseprapë nuk e ndëshkoi gruan.

Një ditë, i Dërguari i Allahut zbriti të pushonte nën hijen e një peme të dendur. Aty vari shpatën dhe ra të flinte.

Njerëzit e tjerë u shpërndanë nëpër hijet e pemëve dhe fjetën.

Ndërkohë vajti një idhujtar dhe e kapi shpatën e të Dërguarit të Allahut kur ai po flinte. Kur u zgjua e pa idhujtarin me shpatë në dorë, që po i thoshte: - A ke frikë nga unë?

I Dërguari i Allahut i tha: - Jo.

- Kush të mbron ty tani nga unë? – e kërcënoi përsëri idhujtari.

- Allahu - ia ktheu i Dërguari i Allahut.

Nga toni i zërit të Pejgamberit idhujtarit i ra shpata nga dora.

Shpatën e kapi i Dërguari i Allahut dhe i thotë:.

- Po ty kush të mbron nga unë tani?

Idhujtari i thotë: - Të lutem mos më vrit!

Pejgamberi e fton atë për në Islam.

Idhujtari nuk e pranon ftesën të bëhet musliman.

Idhujtari i dha besën Pejgamberit se nuk do të luftonte kurrë më kundër tij.

Idhujtari i dha besën se nuk do të bashkohej kurrë me ata që e luftonin.

Muhamedi a.s. e la të lirë dhe ai shkoi te njerëzit e vet.

Kur shkoi te njerëzit e vet, atyre u thotë:

- **Vërtet, unë po vij te ju nga ai njeri, që është më i miri i njerëzve.**

Ndodhia e Surakës

Muhamedi a.s. së bashku me Ebu Bekrin ishin duke shkuar rrugës për në Medine. Mekasit kishin vendosur shpërblim prej 100 deveve për atë që e zë Muhamedin a.s. para se të shkonte në Medine.

Suraka kishte një kalë.
Ai e merr kalin dhe u shkon pas për t'i zënë.

Hipur mbi kalë Suraka po ecte me shpejtësi në drejtim të tyre.

Para se t'u afrohej, kali i Surakës rrëshqiti.
Suraka bie nga kali.

Suraka hodhi fall.
I doli ashtu siç dëshironte dhe në zemër i hyri një trishtim i madh.

Hipi mbi kali.
U afrua tek ata aq shumë, por i dërguari i Allahut nuk po shikonte rreth e qark.
Ebu Bekri vështronte sa majtas e sa djathtas.
Suraka mendoi se tash ishte çasti më i volitshëm për ta kapur Muhamedin a.s.

Në atë moment i ndodhi diçka e çuditshme.
Kalit të Surakës i humbën këmbët në tokë, deri në gjunjë.
Suraka ra nga kali.

E tërhoqi kalin dhe ai u çua, por me vështirësi ia nxori këmbët nga toka.

Pas shumë përpjekjesh, kali i nxori këmbët plotësisht.
Nga dheu i këmbëve të kalit u çua një pluhur që u ngjit në qiell si tym.

Suraka e kuptoi se i Dërguari i Allahut do të triumfonte, prandaj u thirri atyre:
- Më prisni, se nuk do t'ju bëj asgjë të keqe!

Pejgamberi dhe Ebu Bekri u ndalën dhe e pritën atë.
Suraka iu tha se nuk do t'ju bënte atyre asgjë të keqe vetëm e vetëm ta lejonin të kthehej mbrapa.
Muhamedi a.s e lejoi.
Suraka u kthye kah kishte ardhur.
Muhamedi a.s. së bashku me Ebu Bekrin vazhduan rrugën për në Medine.

Melekët në luftën e Bedrit

Melekët kryejnë punë të shumta.
 Prej punëve kryesore janë ato punë që kanë të bëjnë me besimtarët.
 Melekët u ndihmojnë besimtarëve.
 Melekët u ndihmojnë atyre të cilët e falin namazin.
 Melekët u ndihmojnë atyre të cilët e japin Zekatin.
 Melekët u ndihmojnë atyre të cilët e agjërojnë Ramazanin.
 Melekët u ndihmojnë atyre të cilët e kryejnë Haxhin.

Ishte beteja e Bedrit.
 Besimtarët ishin pak.
 Besimtarët ishin të zbathur.
 Besimtarët ishin të pambrojtur.

Jobesimtarët ishin shumë.
 Jobesimtarët ishin të përgatitur mirë dhe të mbrojtur mirë.

Xhibrili shkon te i Dërguari i Allahut dhe e pyeti:
 - Si i njihni ndër ju ata që kanë marrë pjesë në këtë luftë?
 I Dërguari i Allahut i thotë:
 - Ne i njohim ata si më të virtytshmit e muslimanëve.
 Xhibrili i thotë:
 - Edhe ne Melekët që po marrin pjesë në luftën e Bedrit, i njohim si më të virtytshmit e Melekëve!

Zoti i Madhëruar thotë:
 “Allahu ju ka ndihmuar në Bedër, kur ju keni qenë të dobët dhe të pafuqishëm.
 Pra frikojuni vetëm Allahut që të jeni falënderues.
 Përkujto (o Muhamed) kur u thoshe besimtarëve: - A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë melekë të zbritur (në mesin tuaj për ndihmë).
 Po! Po! (Ju mjaftojnë). Nëse ata ju sulmojnë bëhuni të durueshëm dhe të dëgjueshëm dhe Zoti juaj menjëherë do të ju dërgojë në ndihmë pesë mijë melekë të shënuar me shenjë të dalluar.”

Dëshmimi i pemëve për pejgamberin a.s.

Enes bin Malik ishte së bashku me të Dërguarin e Allahut.

Zbritën në një luginë të gjerë.

Ai u largua për të kryer nevojën.

Enesi e ndoqi nga larg me një enë me ujë.

I dërguari i Allahut u ndal, pa përreth por nuk i zuri syri ndonjë gjë për t'u fshehur.

Në skaj të luginës i zunë sytë dy pemë.

I Dërguari i Allahut u nis menjëherë drejt tyre.

U afrua te njëra pemë, zuri me dorë një degë të saj dhe u lut:

- Me lejen e Allahut, përkulu para meje!

Dega u përkul para tij si deveja që i nënshtrohet të zotit të tij dhe e zuri krejt pamjen në atë anë.

Pastaj i Dërguari i Allahut shkoi te pema tjetër, zuri një degë dhe u lut:

- Me leje të Allahut, përkulu para meje!

Dega përkulet para Muhamedit a.s. duke ia zënë edhe atë anë.

Pastaj, mes dy pemëve, i Dërguari i Allahut u lut:

Me lejen e Allahut, më mbuloni nga sipër!

Me lejen e Allahut degët e pemëve e mbuluan të Dërguarin e Allahut edhe nga sipër.

Një ditë i Dërguari i Allahut ishte duke udhëtuar.

Takoi një njeri i cili jetonte në bjeshkë.

Muhamedi a.s. e pyeti:

- Ku po shkon?

Njeriu i tha:

- Te familja ime.

Pejgamberi a.s. i tha atij njeriu:

- A do një të mirë?

Njeriu pyeti:

- Çfarë është ajo e mirë?

Pejgamberi a.s. tha:

Të dëshmosh se nuk ka të adhurar tjetër me meritë pos Allahut një e të pashoq dhe se unë jam rob dhe i dërguari i Tij.

Njeriu pyeti përsëri:

- Kush dëshmon për këtë që e thua ti?

I Dërguari i Allahut tha:

- Për këtë dëshmon ky lis i cili gjendet afër ne të dyve.

Pejgamberi a.s. e thirr lisin.

Lisi u afrua duke e shqyer tokën derisa u ndal para Muhamedit a.s.

Pejgamberi kërkoi nga lisi që të dëshmojë tri herë se:

Nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij.

Pasi dëshmoi për këtë, lisi u kthye tek vendi ku ishte më parë.

Njeriu u çudit për këtë që pa dhe besoi në Allahun dhe Pejgamberin a.s.

Pasi e pranoi Islamin shkoi tek populli i vet t'i thërras në islam.

I dërguari a.s. nuk kishte minber që të ligjëronte mbi të.
Ai ligjëronte mbi një trung të hurmës.
Një ditë erdhi një grua prej ensarëve,
e cila e kishte një djalë zdrukthëtar.
I kërkoi leje të dërguarit që djali i saj t'ia ndërtonte një minber.
I dërguari a.s. u pajtua.
Në xhumanë e ardhshme sahabët e larguan trungun.
Kurse minberin e ri e vendosën në drejtim të kibles.
I dërguari a.s. hipi mbi të që të ligjëronte.

Trungu filloi të qajë.
Qau aq shumë saqë edhe sahabët e të dërguarit e dëgjonin të qarit që i ngjasonte zërit të
devesë gjatë lindjes.
I Dërguari i Allahut shkoi te trungu.
E përkëdheli.
E fërkoi me dorë.
Pasi e përkëdheli, zëri rënkues i trungut u ndalë.
Trungu ishte i mërzhitur për shkak të ndarjes nga i dërguari a.s.

Mrekullia e të dërguarit në hapjen e hendekut

Sahabët ishin duke bërë hapjen e hendekut.

Ata i ndihmonte edhe i dërguari a.s.

Gjatë hapjes së hendekut hasën në një shkëmb të fortë.

Sahabët nuk mundën ta thyenin dhe ta hapnin hendekun.

Shkuan tek i dërguari për t'i treguar për të.

I dërguari shkoi menjëherë tek vendi ku ndodhej shkëmbi i fortë.

E mori çekanin, zbriti afër tij dhe tha: **Bismilah**.

E goditi shkëmbin me një goditje të fortë dhe e theu një të tretën e tij.

Atëherë i dërguari a.s. tha: **Allahu Ekber**, m'u dhanë çelësat e Shamit.

E goditi herën e dytë dhe u thye një e treta tjetër.

Atëherë i dërguari a.s. tha: **Allahu Ekber**, m'u dhanë çelësat e Persisë.

E goditi herën e tretë dhe u thye i gjithë shkëmbi.

Atëherë i dërguari a.s. tha: **Allahu Ekber**, m'u dhanë çelësat e Jemenit.

Kaloi një periudhë kohore dhe muslimanët i çliruan ato vende.

I panë pallatet ashtu siç ua kishte përshkruar Muhamedi a.s.

Deveja i bie në sexhde Muhamedit a.s.

Ishte një familje prej ensarëve.
Ensar (ndihmëtar) quhen banorët e Medinës.
Banorët e Medinës i kanë ndihmuar Muhamedit a.s.,
për këtë arsye janë quajtur Ensarë.

Një familje e ensarëve e kishte një deve me të cilën e ujitnin tokën e tyre.
Një ditë prej ditëve deveja u egërsua.
Nuk u bindej pronarëve të saj.
Toka u ishte tharë për shkak se deveja nuk po u bindej.
Ata shkuan tek i dërguari dhe ju ankuan atij për gjendjen e devesë.

Shkoi i dërguari te deveja në shtëpinë e tyre.
Sahabët frikësoheshin se mos po i ndodhte diç të dërguarit të Allahut.
I dërguari i Allahut i lajmëroi ata se nuk do ta godet diçka e keqe.
U afrua tek deveja.
Pastaj deveja erdhi me nxitim tek i dërguari dhe ra në sexhde para tij.
U ngrit i dërguari Allahut dhe e kapi për balluke dhe e futi në punë.

Muslimanët ishin duke e hapur një hendek rreth Medines për t'u mbrojtur nga idhujtarët. Kaluan tri ditë.

Gjatë hapjes së hendekut muslimanët ishin shumë të uritur.

Xhabir ibn Abdullahu e shikoi pejgamberin dhe i pa gjurmët e urisë në fytyrën e tij.

Xhabiri r.a. shkoi te bashkëshortja e tij dhe e urdhëroi që ta therë një dele dhe të përgatit ushqim për të dërguarin.

Shkoi Xhabiri te i dërguari dhe fshehtas i tha:

- Kemi përgatitur ushqim për ty o i dërguar i Allahut.

U ngrit i dërguari a.s. dhe i thirri të gjithë sahabët duke ju thënë:

- O punëtorët e Hendekut, Xhabiri ka përgatitur ushqim për ne.

U ndal Xhabiri r.a. duke menduar:

- Si do të hanë një mijë veta ushqim kurse ushqimi nuk mjafton me shumë se sa për tre veta!

I dërguari a.s. i tha atij: - Mos përgatitni ushqim deri sa të vij unë.

U nis Xhabiri r.a. për në shtëpinë e tij me të dërguarin dhe shokët e tij.

Kur e pa gruaja e Xhabirit r.a. se i dërguari ka ardhur dhe me të gjendet edhe e gjithë ushtria e tij, filloi ta qortojë burrin e saj.

Xhabiri r.a. i tha asaj: - Ata i thirri i dërguari a.s. dhe ai e dinte se sa kemi ushqim.

Atëherë ajo u qetësua dhe tha: - Përderisa i ka thirrur i dërguari a.s. atëherë s'ka gjë të keqe.

Shkoi i dërguari dhe bëri lutje në brumë duke thënë **Bismilah**.

Pastaj tha: - Tani përgatiteni brumin tuaj.

E përgatitën ushqimin.

Xhabiri r.a. i thërriste sahabët dhjetë nga dhjetë.

Ata hanin dhe ushqimi mbetej ashtu siç ishte.

U ushqyen një mijë veta dhe nuk u pakësua asgjë nga ushqimi.

Hëngri edhe i dërguari a.s.

Pastaj ia afroi ushqimin edhe Xhabirit dhe i tha që të ha ai dhe gruaja e tij.

Pastaj nga ushqimi t'ju dhuroj edhe fqinjëve.

Kur'ani, mrekulli e Muhamedit a.s.

Mrekullia më e madhe dhe më e fuqishme është Kur'ani.
Kur'ani është mrekullia e cila nuk do të përfundojë kurrë.
Kur'ani nuk është fjalë njerëzish.
Kur'ani nuk është fjalë shkencëtarësh.
Kur'ani nuk është fjalë filozofësh.
Kur'ani është fjalë e Zotit të gjithësisë.
Kur'ani është fjalë e Krijuesit.
Vlera e Kur'anit nuk matet me vlerën e asnjë fjale tjetër.

Kur'ani, fjala e Zotit do të mbetet gjithmonë, për aq kohë sa do të flasin njerëzit.
A mund të ketë fjala peshë më të madhe, sesa kur e flet Zoti i Lartmadhëruar.

Zoti i Lartmadhëruar kur flet për këtë Kur'an thotë:

“Sikur Ne ta zbrisnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga Allahu...”

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Shembulli i besimtarit që lexon Kur'an është si shembulli i portokallit:

- Shijen e ka të mirë.
- Erën e ka të mirë.

Shembulli i besimtarit që nuk e lexon Kur'anin është si shembulli i hurmës:

- Shijen e ka të mirë.
- Nuk ka erë.

Munafiku që lexon Kur'an është si shembulli i borzilokut:

- Erën e ka të mirë.
- Shijen e ka të keqe.

Munafiku që nuk lexon Kur'an është si puna e kungullit të egër.

- Erën e ka të keqe.
- Shijen e ka të keqe.

Muhamedi a.s. dhe Aliu r.a.

Një ditë Muhamedi a.s. ishte me Aliun r.a.

Muhamedi a.s. i thotë:

- Pas meje do të ketë shumë probleme dhe trazira.

Aliu r.a. e pyeti:

- O i dërguar i Allahut, cila është rrugëdalja prej trazirave?

Muhamedi a.s. i thotë:

- Libri i Zotit është rrugëdalja prej trazirave.

Në Kur'an është njoftimi i atyre që ishin përpara jush.

Në Kur'an është njoftimi atyre që do të jenë pas jush.

Ai është Gjykatësi që gjithmonë gjykon drejtë.

Allahu do ta copëtojë çdo tiran që e braktis Kur'anin.

Këdo që kërkon ndihmë përveç Kur'anit, Allahu xh.sh. do ta humbë.

Këdo që kërkon udhëzim përveç Kur'anit, Allahu xh.sh. do ta humbë.

Kur'ani është litari i fortë.

Kujtuesi i urtë.

Është rruga e drejtë, që kurrë nuk do të të humbasë.

Gjuha nuk lodhet me leximin e tij.

Nga leximi i tij nuk ngopen dijetarët.

Zemra nuk mërzhitet asnjëherë nga përmendja e tij.

Mrekullitë e tij nuk mbarojnë kurrë.

Kush flet me të, ka folur drejtë.

Kush gjykon me të, ka gjykuar drejtë.

Kush fton për tek ai, ka ftuar për tek e drejta dhe është gjithmonë i drejtuar.

PASTRIMI I ZEMRËS SË MUHAMEDIT A.S.	6
ISRA-JA	7
MIRAXHI	8
TAKIMI I MUHAMEDIT A.S. ME ADEMIN A.S.	9
GJATË MIRAXHIT, PREJ QIELLIT TË DYTË DERI NË QIELLIN E GJASHTË.....	10
TAKIMI I MUHAMEDIT A.S. ME IBRAHIMIN A.S.	11
PËRSHËNDETJA PREJ BANORËVE TË QIELLIT PËR MUHAMEDIN A.S.	12
BEJTUL MAËMURË	13
SIDRETUL MUNTEHA.....	14
OBLIGUESHMËRIA NË SIDRETUL MUNTEHA.....	15
KEVTHERI	16
LUTJA E PËRSHËNDETJES (ETTEHIJATU).....	17
MREKULLIA E UJIT	18
MERIMANGA NË SHPELLËN THEVR	19
PËLLUMBI NË SHPELLËN THEVR	20
TË FOLURIT E QENGJIT	21
MBROJTJA DHE SIGURIA E MUHAMEDIT A.S.....	22
NDODHIA E SURAKËS.....	23
MELEKËT NË LUFTËN E BEDRIT	24
DËSHMIMI I PEMËVE PËR PEJGAMBERIN A.S.	25
DËSHMIA E LISIT	26
TË QARIT E TRUNGUT NGA MALLI PËR MUHAMEDIN A.S.....	27
MREKULLIA E TË DËRGUARIT NË HAPJEN E HENDEKUT	28
DEVEJA I BIE NË SEXHDE MUHAMEDIT A.S.....	29
SHTIMI I USHQIMIT NË SHTËPINË E XHABIRIT R.A.....	30
KUR’ANI, MREKULLI E MUHAMEDIT A.S.	31
AROMA E KUR’ANIT	32
MUHAMEDI A.S. DHE ALIU R.A.	33